



Nr. Prot. 269

Tiranë, më 22/7/24

**Kriteret dhe Procedurat e Pranimi për Shtetas Shqiptarë
në Programin e Integruar të Studimit të Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në
Arkitekturë**

Raundi i parë, viti akademik 2024- 2025

Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në *Arkitekturë* ka një kohëzgjatje prej 5 vitesh akademike dhe zhvillohet në gjuhën italiane.

I. Kuotat dhe kriteret e pranimi

Në vitin akademik 2024 - 2025, për raundin e parë, në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në *Arkitekturë* do të vihen në dispozicion të kandidatëve shtetas shqiptarë **50 kuota pranimi**.

Kandidatët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm;
- plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave VKM nr. 436, dt. 03.06.2020 i ndryshuar me VKM nr. 46 dt. 27.01.2021 sipas së cilit nota mesatare për t'u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në vitin akademik 2024-2025, **duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 6.5;**
- nuk mund të ndjekin njëkohësisht më shumë se një program studimi në të njëjtin vit akademik, në universite publike dhe/ose jopublike, shqiptare dhe/ose të huaja.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nëpërmjet kriterëve të mëposhtme:

1. Testim me shkrim, në italisht, i organizuar në formë pyetjesh me alternativa, për të vlerësuar njohuritë e kulturës së përgjithshme të zotëruar nga kandidati.	30 pikë
2. Nota mesatare e përgjithshme e shkollës së mesme	30 pikë
Total	60 pikë

Testimi i pranimi të raundit të parë do të zhvillohet në **datën 20 gusht 2024, ora 11:00** në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" Rr. Dritan Hoxha, Tiranë, Shqipëri.

II. Pjesëmarrja në testimin e pranimi

Për të aplikuar në raundin e parë, kandidatët duhet të përzgjedhin në portalin online U-Albania: <https://ualbania.arsimi.gov.al/> programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në *Arkitekturë* të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", **në datat 30 korrik - 4 gusht 2024.**



Për të marrë pjesë në testim, nga data **08 gusht 2024** deri **16 gusht 2024** ora **16:30**, kandidatët duhet të:

- dërgojnë me e-mail në adresën elektronike: info@unizkm.al kopjen e kartës së identitetit duke specifikuar atësinë dhe një nr. telefoni;
- paguajnë tarifën e regjistrimit në testim prej 2.000 lekë si më poshtë:
 - pranë filialeve të Bankës Intesa SanPaolo në llogarinë¹ me këto të dhëna:
Përfituesi: Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë (Universiteti Katolik)
1. IBAN AL60208112040000030694935302 për pagesat në Euro;
2. IBAN AL06208112040000030694935304 për pagesat në Lekë.
 - me kartë krediti në internet në portalin me këtë adresë: <https://admissions.unizkm.al/#/auth/signin>
 - pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", e disponueshme nga e hëna në të premte, nga ora 08:00-16:30.

Pjesëmarrësit duhet të paraqiten pranë Sekretarisë Mësimore të paktën 30 minuta përpara fillimit të testimit dhe duhet të jenë të pajisur me një dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë). Gjatë zhvillimit të testimit është i ndaluar përdorimi apo mbajtja e mjeteve elektronike të komunikimit (telefonë celularë, I-Phone, I-Pad, etj.). Në rast konstatimi, pjesëmarrësit do të përjashtohen menjëherë nga testimi.

Renditja e kandidatëve dhe përcaktimi i fituesve do të bëhet mbi bazën e rezultateve finale individuale, duke ndjekur rendin zbritës të pikëve të fituara. Lista e renditjes së kandidatëve do të afishohet në ambientet e Universitetit dhe do të publikohet në faqen zyrtare: www.unizkm.al në datën **25 gusht 2024**.

III. Procesi i regjistrimit

Në datat **30 gusht - 13 shtator 2024** të gjithë kandidatët që janë shpallur fitues në testimin e pranimit të raundit të parë duhet të regjistrohen pranë Sekretarisë Mësimore. Sipas Udhëzimit nr. 12, dt. 30. 06. 2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) kjo periudhë është e ndarë në 7 faza 48-orëshe (30- 31; 01- 02; 03- 04; 06- 07; 08- 09; 10- 11; 12-13). *Kandidatit të shpallur fitues, i dërgohet një e-mail nga Sekretaria Mësimore ku i komunikohen dokumentet e nevojshme për regjistrim dhe afati 48 orësh i kandidatit.* Kur kandidati është shpallur fitues, ai duhet të paraqitet pranë Sekretarisë Mësimore brenda afatit 48-orësh. Nëse kandidati nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit dhe Sekretaria Mësimore thërret automatikisht kandidatin tjetër. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 13 shtator 2024. Nëse pas përfundimit të listës së renditjes, do të mbeten ende kuota të paplotësuara dhe nuk do të ketë kandidatë në pritje, do të rikthehen në garë kandidatet e shpallur fitues të cilët nuk janë paraqitur për regjistrim në fazat paraardhëse dhe nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Kandidatët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t' u regjistruar në këtë raund, por kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit të dytë

¹ Ju lutemi të specifikoni në Urdhërpagesë emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe programin e studimit për të cilin po kryeni pagesën. Ditën e testimit duhet të paraqisni kopje të mandat-pagesës duke qënë se koha e mbërritjes së pagesave është e kufizuar.



UNIVERSITETI KATOLIK ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Për t'u regjistruar, kandidatët e shpallur fitues duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Mandatpagesë nga Banka për shlyerjen e këstit të parë ose të këstit të plotë² të tarifës vjetore të studimit (Urdhërpagesa për t'u paraqitur në bankë shkarkohet nga portali studentit: portal.unizkm.al, zëri "Tariffe").
- Kopje të njehësuar me origjinalin të Diplomë së Maturës Shtetërore/ Dëftesës së pjekurisë ose të një diplome studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehësuar nga QSHA- ja, së bashku me çertifikatën përkatëse të notave.
- Raport mjeko-ligjor që vërteton aftësinë për të ndjekur studimet;
- Vërtetim banimi;
- Certifikatë familjare;
- Fotokopje e një dokumenti identifikimi të vlefshëm (kartë identiteti ose pasaportë);
- Certifikata Ndërkombëtare e Njohurive Gjuhësore në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor" dhe në zbatim të dekreteve në fuqi (nëse kandidati ka detyrimin për ta dorëzuar);
- 2 fotografi, format dokumenti.

Gjithashtu pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen:

- Kërkesa e regjistrimit (kërkesa mund të shkarkohet edhe nga portali studentit: portal.unizkm.al);
- Deklarata e paraqitur në Shtojcat nr. 1 dhe nr. 2 e Udhëzimit nr. 12 dt. 30. 06. 2023 përkatëse;
- Kontrata e regjistrimit;

IV. Procesi i çregjistrimit

Kandidati ka të drejtë të çregjistrohet vetëm **në datat 14 - 15 shtator 2024**. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë Sekretarisë Mësimore duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse ky veprim nuk kryhet në këto data, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania dhe pranë Sekretarisë Mësimore.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi



² Në rastet kur kandidati plotëson kushtet e parashikuara në Rregulloren e Tarifave për përfitimin e bursës vjetore, detyrimi i tij do të jetë në përputhje me tarifën e mbetur.